



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

**RAPORT**  
**I**  
**AVOKATIT TË POPULLIT**

**A. nr. 458/2022**

**Alim Noci**

*në lidhje me cenimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si pasojë e derdhjes së kanalizimeve në kanalën e ujërave atmosferike, në fshatin Dujakë të komunës së Gjakovës*

Për:

Z. Ardian Gijini, kryetar i komunës së Gjakovës

Kopje:

Z. Habit Hajredini, drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, 29 prill 2024

## Qëllimi i raportit

1. Raporti ka për qëllim t'i vlerësojë detyrimet e autoriteteve përgjegjëse përkitazi me cenimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të së drejtës së privatësisë, të së drejtës së jetës dhe të të drejtave të familjeve në një lagje të fshatit Dujakë të komunës së Gjakovës.
2. Avokati i Popullit, nëpërmjet Raportit, mëton që përmes instrumenteve ndërkombëtare, bazës kushtetuese dhe ligjore, t'i argumentojë përgjegjësitë e shtetit për evitimin e ndikimit të efekteve të dëmshme të shkarkimeve të ujërave të patrajuara në kanalën për ujitje dhe në mjedis.
3. Avokati i Popullit, po ashtu në Raport, sjell në pah përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore të Komunës së Gjakovës për mbrojtjen e mjedisit edhe pas marrjes së rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK).

## Kompetenca e Avokatit të Popullit

4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: *"Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike."* Kurse në paragrafin 3 përcakton: *"Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj."*
5. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - *"Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla."* (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).
  - *"Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit."* (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).
  - *"T'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta."* (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
  - *"Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës."* (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).
  - *"Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës."* (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).

- *“T’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

### **Përshkrimi i çështjes**

6. Ky raport është iniciuar sipas ankesës së z. Alim Nocit (më tej: ankuesi), nga fshati Dujakë i komunës së Gjakovës, parashtruar kundër Komunës së Gjakovës, gjegjësisht kundër Drejtorisë për Shërbime Publike (më tej: DShP) dhe Drejtorisë për Punë Inspektuese (më tej: DPI), përkitazi me pretendimet për cenimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe për mosveprim.
7. Sipas shkresave të lëndës dhe informacioneve që posedojmë, vërehet se ujërat e patrajtuara (ujërat e zeza dhe ato fekale) të rreth posëmbëdhjetë familjeve të lagjes së ankuesit në fshatin Dujakë të komunës së Gjakovës shkarkohen në vijën e ujit atmosferik të fshatit. Sipas ankuesit, si rrjedhojë e shkarkimit të ujërave të patrajtuara në vijën e ujit atmosferik të fshatit, jeta është bërë e padurueshme në atë zonë nga kundërmimi i erërave dhe nga prania e inskteve. Gjendja përkeqësohet sidomos gjatë periudhave me ditë me temperatura të larta.
8. Më 29 korrik 2022, ankuesi i ka dorëzuar tri parashtrës<sup>1</sup> në Komunën e Gjakovës, nëpërmjet të cilave e ka njoftuar kryetarin e komunës si dhe organet e tjera kompetente për gjendjen e krijuar në vendbanimin e tij. Ankuesi ka kërkuar prej tyre ndërmarrjen e masave konkrete për eliminimin e këtij problemi. Kryetari i komunës së Gjakovës, në të njëjtën ditë, parashtrësën e ankuesit e ka përcjellë te DShP-ja, si organ kompetent. Tutje DShP-ja e ka shpallur veten jokompetente dhe e ka dërguar çështjen në DPI, duke kërkuar prej saj ta trajtonte çështjen, si organ kompetent. Më tej DPI-ja e ka njoftuar me shkrim<sup>2</sup> ankuesin se inspektorët kanë dalë në terren dhe kanë konstatuar se në vendin në fjalë kundërmon aromë e pakëndshme nga rrjedhja e kanalit të ujërave të zeza/fekale. Tutje inspektorët në fjalë s’e kanë kontaktuar DShP-në, si organ kompetent, dhe nga ana tjetër i kanë rekomanduar ankuesit t’i drejtohej DShP-së me kërkesë për rregullimin e këtij problemi.
9. Më 18 gusht 2022, ankuesi ka parashtruar kërkesë në IKShPK që, si institucion shëndetësor profesional dhe shkencor në kuptim të mbrojtjes së shëndetit publik, të dilte në terren dhe ta vlerësonte gjendjen higjienike-sanitare dhe epidemiologjike në lagjen e tij.
10. Më 25 gusht 2022, IKShPK-ja me ekipin e përbërë prej specialistëve të shëndetit publik, të specialistëve të ekologjisë humane dhe të specialistëve të epidemiologjisë, kanë shkuar në vendin e ngjarjes dhe e kanë bërë inspektimin e kësaj zone. Më 13 shtator 2022, IKShPK-ja ka lëshuar Raportin nr.5/121, duke konstatuar se nga 15 familje të kyçura në kanal in e destinuar për ujtitje, 4-5 prej tyre vazhdimisht i shkarkonin ujërat e zeza në kanal. Raporti precizonte se derdhja e ujërave të zeza paraqiste rrezik të pandërprerë për shëndetin e

<sup>1</sup> Shih: Parashtrës nr.01-352/03-19226, drejtuar kryetarit të komunës së Gjakovës, Parashtrës nr. 09-352/03-19227 drejtuar Drejtorisë për Shërbime Publike, si dhe Parashtrës nr.14-355/01-19228 drejtuar Drejtorisë për Punë Inspektuese, të gjitha të protokolluara më 29 korrik 2022.

<sup>2</sup> Shih: Parashtrës nr. 14-355/01-19228-09/352-19226-09/352/0319227, e datës 24 gusht 2022.

qytetarëve, është terren i përshtatshëm për shumimin e mikroorganizmave dhe të insekteve dhe se kundërmimi ishte i papranueshëm. Për më tepër, IKShPK-ja ka vlerësuar se kanali me thellësi 1 metër ishte lehtë i qasshëm për fëmijët e kësaj lagjeje dhe paraqiste rrezik për jetën e tyre. Si rrjedhojë, IKShPK-ja i ka rekomanduar DShP-së që sa më parë ta merrte për bazë ankesën e qytetarëve të kësaj lagjeje, që t'u mundësohej kyçja në kanalizimin e fshatit familjeve të cilat ende nuk ishin të kyçura në rrjetin e kanalizimit të fshatit, që të mënjanoheshin kyçjet e ujërave të zeza në këtë kanal si dhe të mbulohej pjesa e hapur e kanalit për ujitje që kalon pranë këtyre familjeve, në mënyrë që të pamundësohej qasja e fëmijëve të kësaj lagjeje.

11. Ankuesi ka thënë se pavarësisht rekomandimeve të IKShPK-së, gjendja në terren vazhdon të mbetet e pandryshuar, meqenëse Komuna e Gjakovës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në kuptim të rregullimit, gjegjësisht të ndryshimit të kësaj gjendjeje.

### **Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit**

12. Më 24 nëntor 2022, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë kryetarit të komunës së Gjakovës, nga i cili ka kërkuar informacione për veprimet që janë ndërmarrë nga Komuna e Gjakovës, në kuptim të zbatimit të rekomandimeve të IKShPK-së në çështjen e ankuesit, por nuk ka marrë përgjigje.
13. Më 12 janar 2023, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë përsëritëse kryetarit të komunës së Gjakovës, nga i cili sërish ka kërkuar informacione lidhur me çështjen në fjalë.
14. Më 20 shkurt 2023, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga kryetari i komunës së Gjakovës, i cili ka njoftuar për disa nga veprimet e lartshënuara të inspektorëve. Edhe pse përgjigja nuk përmbante asnjë informatë lidhur me veprimet e Komunës së Gjakovës për zbatimin e rekomandimeve të IKShPK-së, në përgjigje theksohej se Komuna e Gjakovës i ka përmbushur të gjitha obligimet ligjore kundrejt ankuesit.
15. Më 25 prill 2023 përfaqësuesi i Avokatit të Popullit është takuar me kryetarin e komunës së Gjakovës dhe me udhëheqësin e Zyrës Ligjore. Sipas informatave që ka marrë në takim është kuptuar se kanalizimet së shpejti do të jenë aset i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit (më tej: KRU) "Gjakova" sh.a.. Po ashtu, sipas tyre, Qeveria e Kosovës ka kërkuar nga komunat e Kosovës që të mos planifikonin mjete buxhetore për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve, sepse kjo përgjegjësi tani e tutje bie në fushëveprimin e KRU-ve. Ata gjatë këtij takimi nuk kanë prezantuar asnjë lloj shkresë si argument, por ishin zotuar se të njëjtat do t'i dërgonin më vonë të përfaqësuesi i Avokatit të Popullit.
16. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit i është drejtuar disa herë në formë të shkruar udhëheqësit të Zyrës Ligjore të Komunës së Gjakovës, duke i kërkuar kopje të shkresës me të cilën u ishte kërkuar komunave të mos planifikonin mjete buxhetore për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve, por në kërkesat e tij nuk ka marrë asnjë përgjigje.
17. Më 8 qershor 2023, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka realizuar takim me kryeshefin ekzekutiv të KRU-së "Gjakova"<sup>3</sup>, nga i cili është njoftuar lidhur me përgjegjësitë ligjore që

<sup>3</sup> Statuti i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Gjakova" sh.a., në nenin 6 përkulizon: "Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Gjakova" SH.A., themelohet në zbatim të Ligjit Nr. 03/L.087, "Idhi Ndërmarrjet Publike" dhe Ligjit Nr. 06/L-016, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe është trashëgimtare e Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrosistemi" Holding SH.A."

i ka kompania në drejtim të infrastrukturës së kanalizimeve. Ai po ashtu ka sjellë në vëmendje se doracak i marrëveshjes për bartjen e aseteve të kanalizimit në përgjegjësinë e KRU-ve nuk parasheh zonat rurale, por vetëm qendrat urbane (qytetet).

18. Më 14 qershor 2023, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka kontaktuar me zyrtarët përgjegjës të Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), nga të cilët është informuar lidhur me kompetencat komunale për sa i përket infrastrukturës së lartpërmendur, dhe se Qeveria nuk kishte adresuar ndonjë kërkesë nëpërmjet së cilës do të kërkonte nga komunat të mos planifikonin mjete buxhetore për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve për komunat.
19. Në ditën e njëjtë, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, lidhur me çështjen, i është drejtuar me shkresë udhëheqësit të Departamentit Ligjor në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), duke kërkuar sqarime nëse kjo ministri ka informacione që komunave u është kërkuar nga Qeveria, apo nga ndonjë ministri, që ato të mos planifikonin mjete buxhetore për sa i përket shtrirjes së rrjetit të kanalizimeve dhe mirëmbajtjes së tyre. Më 26 qershor 2023, MAPL-ja i ka dërguar përgjigje përfaqësuesit të Avokatit të Popullit duke precizuar se bazuar në Ligjin nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 14, pika f, përcaktohet qartë se komuna është përgjegjëse për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza etj. Tutje në përgjigjen e MAPL-së thuhet: *“MAPL, nuk ka ndonjë informacion, se njëra nga Ministrinë apo Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar nga komunat të mos planifikojnë mjete buxhetore sa i përket shtrirjes së rrjetit të kanalizimeve dhe mirëmbajtjes së tyre, siç pretendon komuna e Gjakovës se ka pranuar një kërkesë të tillë.”*

### **Baza ligjore**

20. Neni 7, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton: *“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e [...], demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale [...].”*
21. Neni 21, paragrafët 2 dhe 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton si në vijim: *“Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë, Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*
22. Neni 22 i Kushtetutës përcakton: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”* Kurse neni 23 përcakton: *“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”*
23. Duhet theksuar se neni 52, paragrafi 1, i Kushtetutës përcakton: *“Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.”* Kurse neni 53 përcakton: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë,*

*interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*"

24. Kushtetuta i bën drejtpërdrejt të zbatueshme në rendin ligjor të Kosovës një numër të instrumenteve e marrëveshjeve ndërkombëtare nga fusha e të drejtave të njeriut. Nenet 19 dhe 22 kanë përcaktuar që këto akte *zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.*
25. Neni 8, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (4 nëntor 1950) (në tekstin e mëtejshëm: Konventa Evropiane) përcakton: "*Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, hanesës [...].*"
26. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 17, përcakton: "*Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar: [...] e) mbrojtjen e mjedisit lokal, f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të rrexhjes lokale, i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut [...].*"
27. Ligji nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, në nenin 10, paragrafi 1, përcakton: "*Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit ushtron mbikëqyrjen inspektive dhe kontroll përmes inspektimit mjedisor në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes së mjedisit.*" Më tutje neni 22 [Autorizimet dhe detyrat e Inspektorit] i po këtij Ligji, paragrafi 1, përcakton: "*Inspektori në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësiave është i autorizuar që: [...]*
- *1.9. të konstatojë gjendjen faktike përmes shiqimit vizuel, audio dhe video incizimit të cilat mund të shfrytëzohen në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese; [...]*
  - *1.11. të shqiptoj dënimin në të holla në vend ngjarje-gjopa mundatore-sipas këtij ligji apo ligjeve përkatëse në fuqi;*
  - *1.12. të inicioj procedurë kundërvajtëse dhe penale për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore në fuqi ndaj personave fizikë dhe juridikë;*
  - *1.13. të ndërmer masa tjera për të cilat është i autorizuar me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi.*"

Kurse neni 34 i po këtij Ligji përcakton:

*"Inspektori mundet të kërkojë në kuadër të procedurës inspektuese mendim dhe bashkëpunim profesional nga institucionet relevante, nëse kjo është e nevojshme për vlerësim të drejtë të gjendjes faktike."*

28. Neni 26, paragrafi 1, i Ligjit nr.08/L-067 për Inspektimet saktëson: "*Inspektorati përkatës nga fushëveprimi i tij apo Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm mund të propozojë dhe realizojë inspektim në bashkëpunim me institucione të tjera përkatëse nga fushëveprimi i tyre."*

29. Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (më tej: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit), në nenin 1, paragrafi 2, shprehimisht përcakton: “Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.” Ligji në nenin 2, paragrafi 2, saktëson: “Ky ligj synon [...] përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut (par.2.2) [...] bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit (par. 2.4) [...]” Ligji në nenin 34, paragrafi 1, përcakton: “Kur konstatohet ose vërtetohet se personi juridik ose fizik apo autoriteti publik ka shkaktuar **dëm mjedisor** me qëllim ose nga pakujdesia, e cila rezulton me **çrregullime mjedisore**, është i detyruar ta kthejë pjesën e dëmtuar në kushtet që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut apo kapacitetit të përgjithshëm rehabilitues të pjesës së dëmtuar.” Kurse neni 50, paragrafi 3, përcakton: “Komitat, në kuadër të përgjegjësisë të veta të përcaktuara me ligj sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me këtë ligj, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit [...]”
30. Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, në nenin 60 [Lëshimi i ujërave të ndotur], paragrafi 1, përcakton: “Ndalohet, përveç me leje ujore, shkarkimi i masës nga hedhurinat e lëngëta industriale, bujqësore dhe ujërave të ndotura urbane si dhe vajrave të përdorura në kanalizim, në sistemin për kullim, në trupat ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, në brigjet buzë lumit dhe tokave të lagëta.”
31. Ligji nr. 08/L-200 për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse, në nenin 13, paragrafi 1, përkulizon saktësisht se cilat janë masat e përgjithshme për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse dhe te pika 1.7, si masë parandaluese, përcakton: “Mënyanimi i ujërave të ndotura, mbeturinave sipas mënyrës dhe nën kushtet në të cilat sigurohet mbrojtja nga ndotja e ujit dhe e tokës, si dhe mbrojtja nga shtimi i insekteve dhe i brejtësve.”
32. Ligji nr.02/L-78 për Shëndetësinë Publike, neni 6, paragrafi 6.1, përcakton: “Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHIP) hulumton ndikimin e faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë dhe i propozon masat mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme për shëndet.” Kurse paragrafi 6.2 përcakton: “IKSHIPK propozon dhe ndërmerr veprime profesionale dhe u rekomandon institucioneve kompetente eliminimin e mungësive të zbuluara dhe çfarëdo efekti të dëmshëm për shëndet.”
33. Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës<sup>4</sup> [Kapitulli II - Parimet e mbrojtjes së fëmijës], në paragrafin 1 përcakton: “Mbrojtja e jetës së fëmijës është detyrimi kryesor për çdo person, institucion apo organ tjetër.” Ndërsa paragrafi 2 përcakton: “E drejta e fëmijës për mbijetesë dhe zhvillim, që do të thotë e drejta e fëmijës në zhvillimin fizik, mendor, emocional, edukativ, shëndetësor, social si dhe mirëqenia e fëmijës, duhet të jenë të mbrojtura në masën maksimale të mundshme nga çdo person, institucion apo organ tjetër.” Tutje neni 5, paragrafi 1, i po këtij Ligji përcakton: “Të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet

<sup>4</sup> Ligji në tjalë nuk e ka të shënuar nenin 4, e ka nenin 3 dhe neni 5, por mungon neni 4.

*administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta.”*

### **Analiza ligjore**

34. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), akti më i lartë juridik që mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në nenin 21 shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve për t'i respektuar liritë dhe të drejtat e të tjerëve. Kushtetuta, mjedisit dhe mbrojtjes së tij i ka përcaktuar vend të veçantë duke e renditur jo vetëm në Kapitullin e të Drejtave dhe Lirive Themelore, por edhe në mesin e vlerave në të cilat bazohet rendi kushtetues. Neni 7 [Vlerat]: *“1.Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet ..., respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit [...]”* Kushtetuta, duke i dhënë fuqinë e parimit imperativ, në nenin 52, paragrafi 1, shprehimisht përcakton përgjegjësinë e të gjithëve, pa përjashtim, për mbrojtjen e mjedisit jetësor, duke theksuar: *“Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor, dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.”*
35. Avokati i Popullit nga hetimet e zhvilluara dhe dëshmitë e siguruar vëren se organet përgjegjëse të Komunës së Gjakovës nuk kanë vepruar në raport me kërkesat dhe ankesat e vazhdueshme të ankuësit. Sipas Avokatit të Popullit, mosreagimi i autoriteteve komunale, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë ligjore, edhe pas pranimit të Raportit me rekomandime nga IKShPK-ja, i lëshuar më 13 shtator 2022, i cili ka theksuar mundësinë e ndikimit në mjedis dhe në shëndetin e banorëve, në veçanti në shëndetin e fëmijëve, të gjendjes së shkarkimit të ujërave të patrajtuara në vijën e ujit atmosferik/kanalin e destinuar për ujtitje, është tregues që komuna e Gjakovës nuk i ka përmbushur detyrimet pozitive të shtetit për të parandaluar, mënjeluar dhe zgjidhur problemin.
36. Avokati i Popullit, për më tepër, e vlerëson si shqetësuese neglizhencën dhe mosveprimin e DShP-së, si organ përgjegjës për evidentimi dhe lokalizimin e ndotësve të ambientit, dhe DPI-së, për të ndërmarrë masa preventive të menjëhershme për të siguruar mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për banorët, posaçërisht për fëmijët, sidomos pas pranimit të Raportit nga IKShPK-ja, në të cilin ishte konkluduar se derdhja e ujërave të zeza në kanalin e hapur për ujtitje paraqiste rrezik potencial për shëndetin e qytetarëve të lagjes në fjalë. Raporti i kishte rekomanduar DShP-së që ta merrte parasysh ankesën e bazuar të banorëve, t'i kyçte në rjetin e kanalizimit të gjitha familjet që nuk ishin kyçur në këtë rjet, si dhe të mbulohej pjesa e hapur e kanalit për ujtitje, si preventivë e qasjes, gjegjësisht mbrojtjes së jetës së fëmijëve.
37. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se deri në publikimin e këtij raporti, Komuna e Gjakovës nuk ka ndërmarrë veprime në drejtim të zgjidhjes së çështjes së ankuësit, fillimisht duke hartur çështjen nga njëra drejtori në tjetrën, me arsyetimin për mungesë kompetence, e më pas duke mëtuar që t'u shmangej përgjegjësive ligjore duke u thirrur në mungesë kompetence edhe të vetë Komunës së Gjakovës, sjell në vëmendje nenin 17 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, cili nuk u lë komunave asnjë hapësirë për mosveprim në ushtrimin e përgjegjësive ekskluzive për sa i përket çështjes së kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza.
38. Në vazhdim, Avokati i Popullit vëren se edhe pse Ligji nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, neni 26, ia jep



kompetencën inspektorit që: "Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektori konstaton parregullsi, për mënjanimin e të cilave nuk është kompetent, me procesverbal konstaton dhe e njofton organin kompetent", inspektorati, përkundër përgjegjësisve të tyre ligjore dhe seriozitetit të problematikës, nuk ka arritur ta dëshmonte adresimin e çështjes tek organet kompetente.

39. Madje, Ligji nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërlimit, në nenin 34 ka paraparë rastet kur inspektorateve u nevojitet ekspertizë e veçantë për vlerësim të çështjeve, mund të kërkojnë në kuadër të procedurës inspektuese mendim dhe bashkëpunim profesional nga institucionet relevante, nëse kjo është e nevojshme për vlerësim të drejtë të gjendjes faktike. Mundësinë për bashkëpunim të inspektorateve me institucione të tjera përkatëse e ka përcaktuar edhe neni 26, paragrafi 1, i Ligjit nr.08/L-067 për Inspektimet, ku thuhet se inspektorati përkatës nga fushëveprimi i tij apo Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm mund të propozojë dhe realizojë inspektim në bashkëpunim me institucione të tjera përkatëse nga fushëveprimi i tyre.
40. Për më tepër, Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, në nenin 60 [Lëshimi i ujërave të ndotura], paragrafi 1, përcakton qartazi se ndalohet (përveç me leje ujore) shkarkimi i masës nga hedhurinat e lëngëta industriale, bujqësore dhe ujërave të ndotura urbane si dhe vajrave të përdorura, në kanalizim, në sistemin për kullim, në trupat ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, në brigjet huzë lumit dhe në tokat e lagëta.
41. Avokati i Popullit vëren se Inspektorati, si autoritetet kompetent komunal, përkundër ankesave dhe informatave të pranuara nga qytetarët lidhur me problematikën dhe mundësinë e ndikimit të ndotjes në shëndetin e banorëve, nuk e ka adresuar çështjen te organet kompetente, Inspektorati nuk ka kërkuar vlerësim zyrtar të gjendjes në terren nga IKShPK-ja, si organ kompetent për hulumtimin e ndikimit të faktorëve mjedisorë në shëndetin e qytetarëve, por kërkesa është iniciuar nga vetë ankuesi.
42. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh konstatimin e IKShPK-së se derdhja e ujërave të zeza në kanal in e hapur për ujitje paraqiste rrezik për shëndetin e qytetarëve të kësaj lagjeje, sjell në vëmendje se neni 13, paragrafi 1.7, i Ligjit nr. 08/L-200 për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse e përcakton qartazi si njërin ndër masat e përgjithshme për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjet ngjitëse, mënjanimin e ujërave të ndotura, të mbeturinave, sipas mënyrës dhe kushteve me të cilat sigurohet mbrojtja nga ndotja e ujit dhe e tokës, si dhe mbrojtja nga shtimi i inskteve dhe i brejtësve, prandaj nuk lë asnjë hapësirë për mosveprim të autoriteteve komunale.
43. Avokati i Popullit në këtë drejtim sjell në vëmendje se Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës përcakton qartë se mbrojtja e jetës së fëmijës është detyrim kryesor për çdo person, institucion apo organ tjetër, duke specifikuar se e drejta e fëmijës për mbijetesë dhe zhvillim do të thotë e drejtë e fëmijës në zhvillimin fizik, mendor, emocional, edukativ, shëndetësor, social si dhe mirëqenia e fëmijës duhet të jenë të mbrojtura në masën maksimale të mundshme nga çdo person, institucion apo organ tjetër. Në këtë drejtim, ligji përcakton se të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta.

44. Në lidhje me obligimin e autoriteteve për të vepruar në rastet e ndotjes mjedisore, Avokati i Popullit sjell në vëmendje se GjEDNJ-ja, në rastin, *Tătar v. România*, që kishte të bënte me shkarkimin në lumë të ujërave të ndotura dhe ndikimit në mjedis, kishte gjetur se edhe pse mungonte dokumenti zyrtar i cili do të vërtetonte në mënyrë të qartë ndikimin e aktivitetit në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin, ekzistonte kërcënim serioz dhe thelbësor për mirëqenien e aplikuesve, shteti kishte obligim pozitiv të ndërmerre masa të arsyeshme dhe të mjaftueshme për t'i mbrojtur të drejtat e palëve të interesuara, të ofronte informacion rreth rreziqeve për shëndetin dhe mirëqenien e tyre, në mënyrë që të respektohej jeta e tyre private, shtëpitë e tyre dhe, në përgjithësi, të sigurohej një mjedis i shëndetshëm, i sigurt. Gjykata kishte vlerësuar se qytetarët duhej të kishin jetuar në një gjendje ankthi dhe pasigurie të theksuar nga qasja pasive e autoriteteve kombëtare dhe në frikë për vazhdimin e aktivitetit. Siç mund të vërehet, situatë e njëjtë na paraqitet edhe në rastin që po e trajton ky raport.
45. Konventa Evropiane, në nenin 8, paragrafi 1, përcakton: "*Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës, [...]*" E drejta për mjedis të shëndetshëm zë një vend të veçantë në nenin 8 dhe kjo e drejtë nënkupton respektimin e cilësisë së jetës private si dhe gëzimin e kushteve të shëndetshme të mjedisit ku jeton. Bazuar në praktikën e Gjykatës Evropiane, ndotja e rëndë e mjedisit nga nivelet e larta të kundërmimit, zhurmës, tymit, emelimeve toksike mund të paraqesë ndërhyrje në gëzimin e qetë të shtëpisë së një personi, madje edhe kur ndotja nuk përbën kërcënim serioz për shëndetin e tij.<sup>5</sup> Në disa rrethana, Konventa Evropiane u kërkon shteteve të ndërmarrin hapa për t'u siguruar individëve të drejtat e tyre sipas nenit 8 dhe mund të kërkojë t'i mbrojë personat nga aktivitetet e individëve të tjerë privatë që i pengojnë ata t'i gëzojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre.
46. Duke pasur parasysh ndikimin e ndotjes nga ujërat e zeza, kundërmimin, zhvillimin e insekteve dhe mundësinë e pickimit të tyre dhe infeksionet, si rrjedhojë e dështimit të organeve kompetente të Komunës së Gjakovës për t'i përmbushur detyrimet pozitive ndaj qytetarëve, Avokati i Popullit sjell në vëmendje se në rastin *Lopez Ostra kundër Spanjës*<sup>6</sup>, Gjykata Evropiane gjeti shkelje të nenit 8 të Konventës duke konstatuar se ndotja e ambientit mund të afektojë mirëqenien e individit dhe t'ia parandalojë atij të drejtën në gëzimin e qetë të shtëpisë së tij në mënyrë të tillë që të ndikojë negativisht në jetën private dhe familjare. Ndërsa, për sa u përket obligimeve të shtetit për ndërmarrjen e veprimeve pozitive për mbrojtjen e qytetarëve nga ndikimi i ndotjes, gjykata, në rastin *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, u shpreh se shteti i paditur nuk e ka përmbushur detyrimin e tij pozitiv për ta siguruar të drejtën e ankuesve për ta respektuar jetën e tyre private dhe familjare.
47. Për më tepër, kur kemi parasysh vlerësimin e raportit të IKShPK-së për mundësinë e ndikimit të mjedisit në shëndetin e banorëve, Avokati i Popullit sjell në vëmendje vendimin e Gjykatës Evropiane *Dubetska dhe të tjerët kundër Ukrainës*, në të cilin gjykata gjeti shkelje të nenit 8, për arsye të mosarritjes nga autoritetet për gjetjen e zgjidhjes efektive për ndalimin e ndotjes dhe vlerësoi se nuk ka dyshim se ndotja mund të ndikojë negativisht në shëndetin publik në përgjithësi dhe përkeqëson cilësinë e jetës së një individi, edhe pse

<sup>5</sup> Rasti *Taşkıoğlu dhe të tjerët kundër Turqisë*.

<sup>6</sup> Rasti *López Ostra V. Spain*, paragrafi 51.

shpesh është e pamundur për ta përcaktuar efektin e saj në secilin rast individual. Në këtë rast u theksua se të jetosh në një zonë me tejkalime të qarta të standardeve të lejuara nga ndotja përbën rrezik të lartë për shëndetin.

### **Konstatimet e Avokatit të Popullit**

48. Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave dhe të fakteve të mbledhura, analizës mes instrumenteve ndërkombëtare, Kushtetutës së vendit, si dhe ligjeve relevante, të cilat garantojnë respektimin e të drejtat e njeriut dhe përcaktojnë rregullat për përmbushjen e obligimeve pozitive nga shteti, konstaton se mosarritja e përmbushjes së përgjegjësisive nga Komuna e Gjakovës, si autoritet kompetent për infrastrukturë ujore dhe mjedis, nëpërmjet masave efektive kundrejt nevojave të banorëve të fshatit Dujakë, ka ndikuar në kufizimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të së drejtës së privatësisë, në mundësinë e cenimit të së drejtës për jetën, si dhe në cenimin e së drejtës së fëmijëve.
49. Avokati i Popullit konsideron se mosveprimi i Komunës së Gjakovës, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, që i referohen mbrojtjes së mjedisit, shëndetit publik, së drejtës së fëmijës, përgjegjësisive të dala nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe instrumenteve ndërkombëtare, paraqet mosarritje të përmbushjes së pritjeve legjitime të qytetarëve.
50. Duke marrë parasysh përkufizimin e Gjykatës Evropiane: *“Të jetosh në një zonë me tejkalime të qarta të standardeve të lejuara nga ndotja, përbën rrezik të lartë për shëndetin.”*<sup>3</sup>, mosndërmarrja e veprimeve inspektuese nga inspektorati dhe po ashtu veprimeve të tjera nga DShP-ja, me theks të veçantë pas rekomandimeve të qarta të Raportit të IKShPK-së, konsiderohet mosarritje e përmbushjes së obligimeve kushtetuese dhe ligjore nga Komuna e Gjakovës për respektimin e të drejtave të qytetarëve të vet.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla [...]”*; si dhe: *“Të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.”* (Neni 18, paragrafi 1.7).

Prandaj Avokati i Popullit i

### **REKOMANDON**

**Komunës së Gjakovës:**


- 1. Pa vonesa, të ndërmarrë masa për rregullimin e infrastrukturës ujore dhe të kanalizimeve në fshatin Dujakë, sipas rekomandimeve të raportit<sup>4</sup> të IKShPK-së.**
- 2. Pa vonesa, të ndërmarrë masa për ta mbuluar pjesën e hapur të kanalit, i cili paraqet rrezik për jetën dhe sigurinë e fëmijëve dhe të banorëve të tjerë.**

<sup>3</sup> *Dubotska dhe të tjerët kundër Ukrainës.*

<sup>4</sup> Raport nga vlerësimi i gjendjes higjieno-sanitare dhe epidemiologjike në një lagje të fshatit Dujakë, sipas ankesës së z. Alim Necit, nr.5/121, datë 13 shtator 2022.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/1-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

 Naïm Qelaj

Avokat i Popullit